



VENDIM

Nr. 32, datë 13.6.2016

**PËR SHPËRNDARJEN E FINANCIMIT
PËR PROJEKTE TË REJA, THIRRJA I,
PËR VITIN 2016, NGA GRANTI
“SHQIPËRIA DIXHITALE”, PROGRAMI
“SHQIPËRIA DIXHITALE”, SHTYLLA III,
E FONDIT PËR ZHVILLIMIN E
RAJONEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 15 e të aneksit 3, të ligjit nr.147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpërndarjen e financimit për projekte të reja, thirrja I, për vitin 2016, për drejtimin sipas shkronjës “c”, të pikës 1.2, të vendimit nr. 12, datë 10.3.2016, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, nga granti 1: “Shqipëria dixhitale”, programi “Shqipëria dixhitale”, shtylla III, e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Të gjitha autoritetet kontraktuese, projektet e të cilave miratohen për t’u financuar, sipas pikës 1 të këtij vendimi, brenda një jave nga data e publikimit të tij në Fletoren Zyrtare, duhet të paraqesin në sekretariatit teknik, pranë ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, kalendarin me të gjitha afatet e parashikuara për fazat e prokurimit publik të projektit dhe të përdorimit të fondeve, si dhe emrin e personit përgjegjës për informim.

3. Autoritetet kontraktuese për projektet, sipas pikës 1 të këtij vendimi, duhet të kryejnë procedurat e prokurimit publik dhe të lidhjes së koftrates përkatëse për zbatimin e projektit deri në fund të tremujorit të tretë të vitit 2016. Për fondet e projekteve të paprocuruara sipas këtij afati, Komi-

teti për Zhvillimin e Rajoneve ka të drejtën të rishqyrtojë financimin dhe t’i rishpërndajë ato për një projekt tjetër.

4. Ngarkohet sekretariati teknik pranë ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, të kryejë monitorimin e ecurisë së përdorimit të fondeve, sipas kalendarit të paraqitur nga autoritetet kontraktuese, në përputhje me pikën 2 të këtij vendimi, dhe të informojë Ministrinë e Financave, dhe periodikisht Komitetin për Zhvillimin e Rajoneve, përmes Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

5. Ngarkohen ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI
Niko Peleshi

Zëvendëskryeministri	Zëvendëskryetar;
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4	anëtar



Tabela 1. Lista e projekteve të reja për financim, Thirrja I për vitin 2016, përmes Granti 1: “Shqipëria dixhitale”, Programi “Shqipëria dixhitale”, shtylla e III-të e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve

Nr.	Autoriteti kontraktues	Titulli i projektit	Vlera e Projektit (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2016 (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2017 (në lekë)
1	Bashkia Tiranë	Sistem i qendërzuar për menaxhimin e hoteleve dhe taksave të qëndrimit në Bashkinë Tiranë.	48,000,000	33,600,000	14,400,000
TOTALI			48,000,000	33,600,000	14,400,000

Shënim:

1. “Vlera e plotë e projektit” përfaqëson vlerën brenda së cilës caktohet fondi limit për prokurimin e zbatimit të projektit (kur nuk ka financim tjetër nga autoritetet kontraktuese). Kjo vlerë shërben si referencë për përlogaritjen e vlerës së financimit për vitin 2016, dhe korrektohet nga vlera e kontratës, pas nënshkrimit të saj. Fondi i përfutur nga diferenca midis vlerës së projektit dhe vlerës së kontratës (mbas prokurimit), pas nënshkrimit të kontratës, i shtohet portofolit të grantit “Shqipëria dixhitale”, Programi “Shqipëria dixhitale”, shtylla e III-të e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, dhe shpërndahet për financimin e projekteve të reja dhe/ose projekteve në vazhdim. Vlera e plotë e projektit përcillet nga sekretariati teknik (Ministria e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike).
2. “Vlera e financimit për vitin 2016” tregon vlerën e financimit që alokohet nga buxheti i Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2016.
3. “Vlera e financimit për vitin 2017”, tregon vlerën e mbetur të financimit, pas diferencës midis vlerës së kontratës (mbas prokurimit) dhe vlerës së financimit për vitin 2016.
4. Sipas shkresës së Bashkisë Tiranë, drejtuar sekretariatit teknik, nr.17978, datë 10.6.2016, dhe shkresës së sekretariatit teknik, nr.3753, datë 9.6.2016, për këtë projekt sigurohet komunikimi i masave përkatëse, për administrimin e të dhënave dhe përdorimin e sistemit, sipas legjislacionit në fuqi.
5. Autoriteti kontraktues, Bashkia Tiranë, të përfshijë në grupin e punës së projektit, përfaqësues të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, për të siguruar krijimin e lidhjes së këtij projekti me sistemin kombëtar të turizmit.